



Pranimar / Dorezuar Prilimjenar / Prilidato Received / Delivery	30 - 06	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtujca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHOK	3831	2022	1/3	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.488/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.488/2022 të datës 30.05.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

kundër organit të punësimit- Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim me datë 30.06.2022 mori këtë:

V E N D I M

I.DETYROHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rishqyrtimin e kërkesës me numër protokollit 05-1538, të datës 05.04.2022 të parashtruar nga ankuesja

II.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e caktuar në pozitën Zyrtare e buxhetit në Departamentin e buxhetit dhe Financave në sipas akt emërimit të datës 10.02.2012 e nënshkruar me datën 12.03.2012, më datën 05.04.2022 ka bërë kërkesë me numër protokollit 05-1538, për Menaxherin e Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë për përmirësimin e përvojës së punës për shtatë (7) vite, prej vitit 1991-1998.

Ankuesja për shkak të heshtjes administrative nga Menaxheri i Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë lidhur me kërkesën e datës 05.04.2022, ka parashtruar ankesë me datën 30.05.2022

me numër protokoli 3142/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.06.2022, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë. Me datën 07.06.2022 Ministria e Shëndetësisë ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 3142/2022 të datës 30.05.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa e datës 05.04.2022 me numër 05-1538 e parashtruar për Menaxherin e Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë; Vendimi për ekzekutimin e Aktvendimit i datës 21.08.1998; Vendim i datës 21.08.1998; Vërtetim i kopjes nga origjinali; Aktvendimi i Gjykatës Komonale në Mitrovicën e Kosovës i datës 06.02.1996; E-mail zyrtar i datës 30.05.2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 07.06.2022 me numër protokoli 3306/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Vendim i datës 05.08.2015 dhe Akt emërimi i datës 10.02.2012;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të dispozitës së nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda të kthehet në institucionin përkatës (Ministrinë e Shëndetësisë) me qëllim që të detyrohet organi i punësimit të merrë në shqyrtim kërkesën e ankueses me qëllim që të nxjerret akti administrativë nga organi kompetent konformë dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesja me datën 05.04.2022 ka parashtruar kërkesë për Menaxherin e Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë, për përmirësimin e përvojës së punës për shtatë (7) vite, prej vitit 1991-1998, por deri më tani nuk ka reflektuar as me një përgjigje nga Menaxheri i Personelit në ministrinë e Shëndetësisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 18 paragrafi 1 pika 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pasur parasysh faktin se ankuesja ka bërë kërkesë në adresë të zyrtarëve kompetentë të institucionit përkatës që të rregullojë këtë çështje që lidhet me këtë ankesë, por se nga shkresat e lëndës dhe përgjigja nga institucioni kompetentë në lidhje me këtë ankesë nuk kemi hasur në ndonjë veprim konkretë administrativë që merrë në shqyrtim këtë kërkesë me qëllim që të nxjerrin ndonjë akt administrativë në lidhje me këtë kërkesë, andaj mbi këtë bazë të potencuar më lartë obligon Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë që të shqyrtojë kërkesën e ankuesës dhe me rastin e shqyrtimit të kërkesës së ankueses të datës 05.04.2022, të veprojnë konformë legjislacionit në fuqi që rregullonë këtë çështje duke nxjerrë një aktë administrativë sipas kësaj kërkesë/ankese konformë dispozitave ligjore në fuqi, nga se kolegji vlerëson se është obligim i organit kompetentë të punësimit që të përgjigjet konformë dispozitave të LPPA-së (Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative) ndajë qdo kërkesë që adresohet përmes procedurave administrative.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.488/2022, datë 30.06.2022

Sabile AVDYLI



Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivët të KPMSHCK-së.

